



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 30 nëntor 2020
Nr. ref.:RK 1655/20

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI47/20

Parashtrues

Arben Boletini

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktvendimeve të Gjykatës Themelore në Prishtinë
PPR. nr. 47/17, të 3 shkurtit 2017 dhe P.nr. 820/2017, të nxjerra më
27 shkurt 2017; 20 prill 2017 dhe 22 maj 2017**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Arben Boletini, me vendbanim në Fushë Kosovë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimet e kontestuara

2. Parashtruesi i kërkesës i konteston Aktvendimet e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), PPR. nr. 47/17, të 3 shkurtit 2017 dhe P.nr. 820/2017, të nxjerra më 27 shkurt 2017; 20 prill 2017 dhe 22 maj 2017.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimeve të kontestuara, përmes të cilave parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me paragrafët 2 dhe 3 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut] dhe 24 [Barazia para Ligjit], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 22 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollin e saj, Konventën Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe Konventën kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 47 [Kërkesa individuale], të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 9 mars 2020, parashtruesi i kërkesës e parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 19 maj 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha.
7. Më 4 qershor 2020, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës, si dhe kërkoi nga ai që: (i) të sqarojë se cilin akt e konteston para Gjykatës; dhe (ii) a ka shfrytëzuar ndonjë mjet juridik ndaj vendimit që ai e konteston.
8. Në bazë të fletëkthesës të pranuar në Gjykatë, parashtruesi i kërkesës më 23 qershor 2020 ka pranuar njoftimin e Gjykatës dhe kërkesën për informata shtesë.
9. Parashtruesi i kërkesës nuk i është përgjigjur kërkesës së Gjykatës për informatë dhe sqarime shtesë në lidhje me kërkesën e tij.

10. Më 10 nëntor 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që të refuzojë kërkesën e parashtruesit me procedurë të shkurtër.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 2 shkurt 2017, Prokuroria Themelore në Prishtinë paraqiti tek Gjyqtari i Procedurës Paraprake pranë Gjykatës Themelore propozimin PP. II. nr. 662/17, për shqiptimin ndaj parashtruesit të kërkesës të masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor.
12. Më 3 shkurt 2017, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit PPR. nr. 47/17, i caktoi parashtruesit të kërkesës masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej një (1) muaji. Gjykata Themelore vendosi që paraburgimi i parashtruesit të kërkesës të mbahet në Institutin e Psikiatrisë Forenzike, deri në finalizimin e ekzaminimit psikiatrik të tij në këtë Institut.
13. Më 24 shkurt 2017, Prokuroria Themelore në Prishtinë ngriti aktakuzën dhe paraqiti propozim PP. II. nr. 662/17 për caktimin e masës së paraburgimit ndaj parashtruesit të kërkesës, për shkak të dyshimit të kryerjes së veprës penale “Kanosje” nga neni 185, paragrafi 2 i Kodit Penal 04/l-082 të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPRK).
14. Më 27 shkurt 2017, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit P.nr. 820/2017, vazhdoi masën e paraburgimit ndaj parashtruesit të kërkesës, deri më 1 maj 2020.
15. Më 20 prill 2017, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit me të njëjtin numër, P.nr. 820/2017, vendosi që parashtruesit të kërkesës t’i ndërpritej masa e paraburgimit dhe të mbrohet në liri, duke filluar nga 20 prilli 2017.
16. Më 22 maj 2017, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit P.nr. 820/2017, gjeti se parashtruesi i kërkesës e ka kryer veprën penale “Kanosje” nga neni 185, paragrafi 2 i KPRK-së dhe vendosi që parashtruesit të kërkesës t’i:

I. Caktohet masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri;

II. Obligohet parashtruesi i kërkesës që “ti nënshtrohet kontrollit të vazhdueshëm mjekësor në Klinikën e Psikiatrisë në ambientin ku jeton”;

III. Në qoftë se parashtruesi i kërkesës nuk i nënshtrohet trajtimit psikiatrik si në pikën I dhe II të këtij Aktvendimi, Gjykata mund t’i shqiptojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor; dhe

IV. Masën e shqiptuar në pikën I të dispozitivit gjykata do ta pushojë kurdo që do të vërtetohet se ka pushuar nevoja për trajtim të mëtejme e të pandehurit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi i kërkesës në formularin e dorëzuar në Gjykatë në mënyrë specifike ka theksuar se konteston Aktvendimin P.nr. 820/2017, të 20 prillit 2017 të Gjykatës Themelore, përmes të cilit ishte vendosur që parashtruesit të kërkesës t’i ndërpritej masa e paraburgimit dhe të mbrohet në liri. Megjithatë, në kërkesën

e tij parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar edhe Aktvendimin e Gjykatës Themelore, PPR. nr. 47/17, të 3 shkurtit 2017, përkitazi me caktimin e masës së paraburgimit në institut psikiatrik; Aktvendimin e Gjykatës Themelore P.nr. 820/2017, të 27 shkurtit 2017, përkitazi me vazhdimin e masës së paraburgimit; dhe Aktvendimin e Gjykatës Themelore të 22 majit 2017, përmes të cilit ishte konstatuar se parashtruesi ka kryer veprën penale dhe caktimit të masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri.

18. Parashtruesi në kërkesën e tij thekson se *“me këto veprime te pabaza janë shkelur dispozitat ligjore”* dhe janë shkelur paragrafët 2 dhe 3 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut] dhe 24 [Barazia para Ligjit], të Kushtetutës, neni 22 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj, Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.
19. Në kërkesën e tij parashtruesi i kërkesës vetëm thekson se *“unë ankohe me procedurën e cila është zhvilluar ndaj meje , e cila është zhvilluar qe nga data 01.02.2017, kundër meje është ngritur kallzim penal pa asnjë prove apo deshmi e cila vërteton se une jam kryesi i veprës per te cilen une akuzohem. Gjykata Themelore ne Prishtine, Departamenti i Pergjithshem pa baze ligjore e ngarkon me veprën penale për lenden P. nr. 820/2017”*.
20. Në lidhje me shterjen e mjeteve juridike, parashtruesi në kërkesën e tij thekson se *“Nuk kam pasur njohuri në lidhje me procedurat ndaj meje, mirëpo un po ju drejtohem juve si institucion me i larte”*.
21. Në fund parashtruesi i kërkesës nga Gjykata kërkon që: lënda e tij *“te kthehet me rigjykim qe nga fillimi gjithçka, gjithashtu kërkoj edhe dëmshpërblim lidhur me demin e shkaktuar”*.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

22. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafit 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

24. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale] dhe nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.”

(...).

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

25. Fillimisht, Gjykata vëren se kërkesa e parashtruesit të kërkesës nuk ishte e kompletuar me të gjitha të dhënat e nevojshme që Gjykata të procedojë tutje me vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktvendimeve të kontestuara me këtë kërkesë. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës në formularin e kërkesës ka theksuar, shprehimisht, se konteston Aktvendimin e Gjykatës Themelore P.nr. 820/2017, të 20 prillit 2017, përmes të cilit ishte vendosur që atij t'i ndërpritet masa e paraburgimit. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar informatë nëse i ka shteruar të gjithat mjetet juridike para gjykatave të rregullta. Gjykata po ashtu vëren që aktvendim i fundit i Gjykatës Themelore, i nxjerrë në procedurën e zhvilluar ndaj parashtruesit të kërkesës dhe i dorëzuar nga parashtruesi në kërkesën e tij, është Aktvendimi P.nr. 820/2017, i 22 majit 2017, përmes të cilit ishte vendosur që parashtruesi i kërkesës ka kryer veprën penale “Kanosje” dhe të njëjtit i ishte caktuar masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri.
26. Në dritën e kësaj, Gjykata vë në dukje se parashtruesi në kërkesën e tij ka theksuar se i konteston të gjitha procedurat penale të zhvilluara ndaj tij, duke filluar nga 3 shkurti 2017 dhe duke pretenduar se *“është mbajtur padrejtësisht në paraburgim dhe është akuzuar për kryerjen e veprës penale pa ndonjë bazë”*.
27. Gjykata sqaron se në raste të kërkesave të pakompletuara dhe të pa plotësuar, Ligji dhe Rregullorja e punës përcaktojnë procedurën që duhet ndjekur nga Gjykata në mënyrë që parashtrueset t'u jepet mundësi për të kompletuar dhe plotësuar kërkesat e tyre. Në këtë vazhde, Gjykata referohet në paragrafin 4 të nenit 22 [Procedimi i kërkesës], të Ligjit dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve] (2) (e) dhe (h), të Rregullores së punës, të cilët përcaktojnë:

Neni 22

[Procedimi i kërkesës]

[...]

4. Nëse kërkesa [...] nuk është e [...] kompletuar, gjyqtari raportues njofton palët apo pjesëmarrësit përkatës për këtë dhe ia cakton një afat prej jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve për të [...] plotësuar kërkesën [...].”

Rregullit 32

[Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve]

“(2) Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:

[...]

(h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës;

[...]

28. Në lidhje me këtë, Gjykata sjellë në vëmendje se më 4 qershor 2020 e njoftoi parashtruesin e kërkesës në lidhje me kërkesën e tij, duke i kërkuar atij që të saktësojë se cilin Aktvendim specifik e konteston si dhe ta informojë Gjykatën nëse i ka shteruar të gjitha mjetet juridike ndaj aktvendimit të cilin ai e konteston.
29. Gjykata, në bazë të fletëkthesës vëren se parashtruesi i kërkesës njoftimin e Gjykatës dhe kërkesën për informata shtesë e ka pranuar më 23 qershor 2020. Gjykata rithekson se brenda afatit të përcaktuar nga ajo, nuk ka pranuar përgjigje nga parashtruesi i kërkesës në shkresën e Gjykatës, të 4 qershorit 2020, përmes së cilës parashtruesit të kërkesës i është kërkuar dorëzimi i informatave dhe sqarimeve shtesë.
30. Prandaj, Gjykata thekson se përkundër kërkesës së saj për informata dhe sqarime shtesë, parashtruesi i kërkesës nuk e ka plotësuar apo qartësuar kërkesën e tij.
31. Rrjedhimisht Gjykata i referohet rregullit 35 të Rregullores së punës, i cili përcakton si në vijim:

Rregulli 35

[Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës]

“35 (5) Gjykata mund të vendosë të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë përkundër kërkesave të Gjykatës ndaj palës që të plotësojnë apo qartësojnë kërkesën, [...].”

32. Në raste të tilla, Gjykata rikujton se barra për të ndërtuar, sqaruar dhe plotësuar kërkesën bie mbi parashtruesit e kërkesës, të cilët kanë interes të drejtpërdrejtë në mënyrë që pohimet dhe pretendimet e tyre të adresohen në mënyrë efektive nga Gjykata. Në rastet kur parashtruesit e kërkesës nuk i përgjigjen kërkesës së

Gjykatës për qartësimin dhe plotësimin e kërkesës, Gjykata i deklaroi këto kërkesa si të paqarta dhe jo të plota dhe rrjedhimisht nuk i shqyrton pretendimet e parashtruesit të kërkesës (shih rastet e Gjykatës KI48/17, *Sladana Radojković-Marinković*, Gjykata Kushtetuese, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 4 dhjetorit 2017, paragrafi 21; KI89/18, parashtrues *Agim Jashari*, Vendim për refuzim, i 27 nëntorit 2018, paragrafi 29; KI134/18, parashtrues *Bajram Santuri*, Vendim për refuzim, i 16 janarit 2019, paragrafi 36).

33. Prandaj, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush kriteret procedurale për shqyrtim të mëtejshëm, për shkak të mos-kompletimit të saj me dokumentacion mbështetës, ashtu siç është kërkuar nga Gjykata bazuar në nenin 22.4 të Ligjit dhe me rregullin 32 (2) (h) të Rregullores së punës.
34. Rrjedhimisht, Gjykata, në pajtim me rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, përfundon se kërkesa duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 10 nëntor 2020 njëzëri:

VENDOS


- I. TË REFUZOJË kërkesën me procedurë të shkurtër;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Vendim palës;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Bekim Sejdiu



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi